

Lënda: Kthim përgjigje

INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 2502/1 prot., datë 21.06.2023 të Institucionit të Presidentit të Republikës, me të cilën keni adresuar për trajtim kërkesën e një grupi ish të dënuar politikë të regjimit komunist, të cilët kërkojnë dhënien e kësteve të fundit të dëmshpërblimit financiar si ish të dënuar politikë, ju informojmë se:

Në Ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, ndryshuar me Ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009, “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, kreu II, neni 9, 10, 11, 12 përcaktohet se kush janë institucionet përgjegjëse për miratimin, shqyrtimin dhe shpërndarjen e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politik, si në vijim:

Neni 9. Autoriteti përgjegjës për miratimin e dëmshpërblimit

Këshilli i Ministrave është autoriteti përgjegjës që miraton dëmshpërblimin financiar, në përputhje me këtë ligj, i cili, me vendim, përcakton gjenealitetet përkatëse të ish të dënuarit politik, llojin e dënimit, periudhën e plotë të vuajtjes së dënimit, gjithsej, në vite, muaj dhe ditë, sipas rastit, shumën e dëmshpërblimit financiar dhe, sipas rastit, gjenealitetet e sakta të familjarëve të viktimave të pushkatuara dhe masën përkatëse të dëmshpërblimit të tyre.

Neni 10. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave

1. Ministria e Drejtësisë është autoriteti përgjegjës që shqyrton kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kreun V të këtij ligji. Kur, pas shqyrtimit administrativ, rezulton se kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj, Ministria e Drejtësisë i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e dëmshpërblimit.

2. Këshilli i Ministrave shqyrton propozimet e dërguara nga Ministria e Drejtësisë brenda dy javëve kalendarike. Vendimet hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

Neni 11. Autoritetet përgjegjëse për bashkërendimin e punës

1. Ministria e Drejtësisë, gjatë shqyrtimit të kërkesave, bashkërendon punën me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Shërbimin Informativ të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit dhe arkivat e sistemit gjyqësor.

2. Kriteret, procedurat e bashkërendimit të informacionit dhe lloji i përgjigjes për çdo kërkesë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ministria e Brendshme, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, depoziton në Ministrinë e Drejtësisë kopje të njësuara të arkivit për dënimet me internim ose dëbim.

Neni 12. Kriteret për shpërndarjen e fondit, (ndryshuar me Ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)

Në bazë të buxhetit vjetor, të vënë në dispozicion dhe sipas radhës së caktimit të dëmshpërblimit, fondet do të ndahen në mënyrë proporcionale për të gjithë ish të dënuarit dhe familjarët e viktimave të pushkatuara, me kusht që vlera e dëmshpërblimit gjatë fazës së parë të mos jetë më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë. I njëjti mekanizëm do të përsëritet një ose më shumë herë, deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit për të gjithë ish të dënuarit/familjarët e viktimave, me kusht që, në çdo rast, pjesa takuese që kompensohet të mos jetë më e vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Asnjë ish i dënuar apo familjar i tij nuk mund të dëmshpër

Neni 13. Shpërndarja e dëmshpërblimit

1. Ministria e Drejtësisë, brenda 1 jave nga miratimi në Këshillin e Ministrave të vendimit për dëmshpërblimin, i përcjell Ministrisë së Financave kopjen e plotë të dosjeve individuale të ish të dënuarve politikë, që përfitojnë dëmshpërblim, sipas këtij ligji.

2. Ministria e Financave, sipas buxhetit të vënë në dispozicion, shpërndan, në vlerë të plotë, dëmshpërblimin, për çdo të dënuar politik, që përfiton sipas këtij ligji, nëpërmjet çeljes së depozitës bankare, në emër dhe/ose për llogari të tij ose të familjarëve të tij, në një bankë të nivelit të dytë. Dokumenti i çeljes së llogarisë bankare i bashkëlidhet dosjes në Ministrinë e Financave.

3. Ministri i Financave urdhëron shpërndarjen e dëmshpërblimit, sipas radhës së përparësisë së caktuar në nenin 12 të këtij ligji.

Sa më sipër, kërkesa që keni adresuar nuk është kompetencë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.